

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË PEQIN**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Peqin** me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare dhe zbatimin e procedurave për miratimin e studimeve urbanistike*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 38, datë 28.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 162/6, datë 28.04.2014, i ka rekomanduar z. Ilir Rrushi, Kryetar i Bashkisë Peqin, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Nga Bashkia Peqin, të merren masa për tu bërë vetëvlerësimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas komponentëve, duke paraqitur: mjedisin e kontrollit; aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin. Në mjedisin e kontrollit të përcaktohen faktorët, si integritetin, vlerat etike, si dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë, filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve. Të gjitha këto themele duhet të jenë të forta, nëse mjedisi i kontrollit është pozitiv.

*Menjëherë*

**2.** Nga Bashkia Peqin, të merren masa për hartimin e miratimin e akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm.

*Vazhdimisht*

**3.** Nga Bashkia Peqin, të merren masa për të kryer regjistrimin e çeljes së fondeve nga të ardhurat sipas kriterëve të përcaktuara në kapitullin “V” klasa 7 të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

*Menjëherë*

**4.** Nga Bashkia Peqin, të merren masa duke u ngritur Grupi për Strategji Buxhet dhe Integrim, (GSBI) i kryesuar nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, grup i cili të jetë përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) brenda njësive përkatëse, si dhe të ngrihen Ekipet e Menaxhimit të Programit (EMP), në përmbushje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006.

*Vazhdimisht*

**5.** Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të merren masa për përshtatjen e planit vendorë, që ka mbetur në proces miratimi, me rregulloret uniforme dhe dispozitat e këtij ligji, për të bërë të mundur miratimin e planit të përgjithshëm vendorë (PPV) ose planin e përdorimit të tokës (PPT).

*Vazhdimisht*

6. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo dosje të sistemohet dhe të inventarizohet dokumentacioni përfundimtarë që ndodhet nëndosjet përkatëse, në përputhje me nenin 24, germa b, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe të nenit 4 dhe 5 kapitulli II mbi “Detyrat e sekretarit-arkivit të organit të organit shtetërorë” të “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”.

*Vazhdimisht*

7. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast dhe për çdo vendim të zbatohet procedura e protokollimit të dokumentacionit që zbardhin vendimet dhe kërkesat për leje sheshi dhe leje ndërtimi, duke qenë transparent me afatet dhe procedurat që kryhen.

*Vazhdimisht*

8. Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të mos pranohet dhe të mos shqyrtohet kërkesa për leje shfrytëzimi, për vendimet e KRRT-së respektive, pa u plotësuar më parë me dokumentacionin e plotë tekniko ligjorë.

*Vazhdimisht*

9. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të regjistrojnë të dhëna përkatëse, duke krijuar regjistrin e planifikimit të territorit, për territorin që administrojnë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

*Vazhdimisht*

10. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të ushtrojë vazhdimisht kopetencat në lidhje me kontrollin e zhvillimit për zbatimin e instrumenteve të planifikimit dhe të marrin masat përkatëse për të shmangur shkeljet mjedisore dhe abuzimet me territorin.

*Vazhdimisht*

11. Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të rrisë bashkëpunimin me struktura te tjera brenda bashkisë dhe me autoritet e tjera të planifikimit të çdo niveli duke shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

*Vazhdimisht*

12. INUV, të ushtrojë kontrole në të gjitha objektet për të cilat Sektori I Planifikimit të Territorit ka dhënë leje ndërtimi, duke mos përjashtuar objektet me kate të ulëta dhe shtesa kati.

*Në vazhdimësi*

13. Të hartojë regjistrat përkatës dhe të protokollojë ankesat e qytetarëve dhe të gjitha vendimet që merren nga INUV-i, për të bërë të mundur regjistrimin e akteve të nxjerra, veçanti për aktet e vendim gjobave.

*Vazhdimisht*

14. Të merren masa që të gjitha vendimet që merren, të plotësohen sipas formatit të përcaktuar të dokumentacionit ligjorë, të cilët kanë nr. serial dhe është dokument specifik i miratuar.

*Në vazhdimësi*

15. Të dorëzojë në zyrën e arkivit të bashkisë, të gjitha dosjet e subjekteve ndërtuese që kanë përfunduar ndërtimin e objektit, që ka marrë lejen e Përdorimit dhe ka kaluar për regjistrim në ZRPP.

*Menjëherë*

16. Inspektoriati Ndërtimorë Urbanistik Vendorë të rrisë bashkëpunimin me struktura te tjera brenda bashkisë dhe me autoritet e tjera të kontrollit të territorit të çdo niveli, duke shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

*Vazhdimisht*

17. Nga Bashkia Peqin, Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të merren masa për vjeljen e detyrimeve tatimore në **shumën 3,808,788 lekë**, të ndarë.

- nga 7 subjekte të biznesit të madh, në shumën 1.725.000 lekë,

- nga 12 subjekte të biznesit të vogël, në shumën 362,000 lekë.

- nga 93 familje të qytetit të Peqinit për taksën e tokës bujqësore, në Shumën 1,721,788 lekë e ndarë sipas viteve.

*Vazhdimisht*

**18.** Nga Bashkia Peqin, Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të merren masa për hartimin e planeve vjetore për ushtrimin e kontrolleve sipas pikës 10 “Kontrolli tatimor”, të Udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 6.02.2007.

*Menjëherë*

**19.** Nga Bashkia Peqin të merren masa për tu kryer inventarizimi fizik i aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera dhe të bëhet regjistrimi në ZVRPP Elbasan, sipas nenit 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.04. 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pikës 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” për periudhën e viteve 2011-2012 dhe pikës 21, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001.

*Deri më datë 30.05.2014*

**20.** Nga ana e Bashkimit të shoqërive “Xh... & K...” sh.p.k. & “G... C...” sh.p.k. ,duke qenë se punimet e kryera janë brenda afatit të garancisë dhe subjekti zbatues i kontratës nuk është likuiduar plotësisht,. të kryej.

- zëvendësimin e derës të brendshme të blinduar të palestrës e cila rezultojë e dëmtuar plotësisht, në **vlerë 28 000 lekë.**

- të kryej nga fillimi zërin e punimit “Vendosje shtrese me parket importi në palestër”, e cila rezultojë e pa vendosur, ky shërbim të kryet në mënyrë cilësore dhe në përputhje me kushtet teknike të ndërtimit e cila zë **vlerën 1,059,480 lekë.**

Në qoftë se nuk realizohen këto punime nga subjekti i kontraktuar, atëherë autoriteti kontraktor duhet të ndalojë **shumën 1,087,840 lekë**, nga fondi 5% e vlerës së projektit, i bllokuar për afatin e garancisë për punimet e kryera, në zbatim të kushteve të kontratës dhe pikës 6, kreu II, të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001 ”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **1,905,463 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

**1-** Shuma prej **198,576 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar për përfitim më tepër të pagës nga punonjësja e gjendjes Civile F.G. duke u paguar në një klasë më të lartë, veprime në kundërshtim me pikën 1, lidhja nr. 1 klasa e IX-të të vendimin KM 717 datë 23.06.2009” Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore. dhe me ndryshime në VKM 690, datë 9.10.2012 dhe VKM 610, datë 24.07.2013.

*Menjëherë*

**2-** Shuma prej **25,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar për, pagesën e ish punonjësi D.K.me listë pagesës, pa u tatuar mbi tatimin mbi të ardhurat 10 % = **25,000 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000, ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001, udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 3, datë 11.12.2002 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

*Menjëherë*

**3-** Shuma prej **243,500 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar kryetari i bashkisë I.Rr. për blerje mallrash konsumi si kafe, qumësht e çajë, por në asnjë rast nuk ka dokumentacion justifikues ku janë përdorur, dhe për kë, veprime në kundërshtim germën ç, të pikës 1, të VKM nr. 472, datë

02.07.2011” Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” dhe me moszbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” dhe “Marrja në dorëzim e aktiveve të Furnizuara.

**Menjëherë**

**4-** Shuma prej **49,087 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga firma e pastrimit ”S...” për mos kryerjen e shërbimit të pastrimit të Qytetit, duke raportuar më tepër në situacion dhe faturën tatimore, veprime në kundërshtim me nenin 4, çmimi i kontratës, të kontratës nr. 2 datë 15.02.2011.

**Menjëherë**

**5 -** Shuma prej **387,600 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga, F.D. 291,600 lekë, D. K. 60,000 lekë dhe I.S. 36,000 lekë, punonjës të bashkisë. Për përfitim më tepër të pagës të cilët rezultojnë me arsim të mesëm dhe me diplomën e arsimit Universitar “Diplomë e Nivelit të Parë” (DNP), ku kanë përfituar pagesën për “Diplomë e Nivelit të Dytë” (DND), në kundërshtim me VKM 553, datë 11.8.2011, lidhja 6 pika 3, dhe VKM nr. 518, datë 16.08.2012 po lidhja 6 pika 3, për disa ndryshime në VKM Nr. 1619 datë 02.07.08 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.

**Menjëherë**

**6-Shumën 336,000 lekë**, dëm ekonomik të shkaktuar nga, subjektit ndërtim projektim “B...” sh.p.k., në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 28, pika 1, VKM. nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kreu II, pika 2, germa “a, me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12, ”.

**Menjëherë**

**7-Nuk janë kryer punimet në 3 zëra, në shumën 145,880 lekë**, nga bashkimi i Shoqërive “Xh...&K...” Sh.p.k dhe “G...C...” sh.p.k.Peqin, në tenderin me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Zihni Magani”+ ndërtim i palestrës së re”, në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe mos zbatimin e Kontratës e punimeve nr. 237, datë 09.08.2012.

**Menjëherë**

**8-Nuk janë kryer punimet në 5 zëra, në shumën 519,820 lekë**, nga operatorit ekonomik “B... & G... C...” sh.p.k. në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Chateau Linza – Shkoz Kludiana” në kundërshtim me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me mos zbatimin e kontratës për punë publike nr. 217, datë 16.07.2011.

**Menjëherë**

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7; pikat, 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të kreut II-<sup>të</sup> dhe pikat 4, 5 të kreut III-<sup>të</sup> të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i propozohet: Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik, pranë Bashkisë Peqin, që të **gjohisë në shumën 100.000 lekë, secilin nga personat e mëposhtëm:**

1. **Dh.D.** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK 1890 datë 04.10.2010, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në shumën **145,880 lekë**, sipas preventivit dhe kontratës mos zbatimin e Kontratës të punimeve nr. 237, datë 09.08.2012, në objektin: “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Zihni Magani”+ ndërtim i palestrës së re”. Në shumën **519,820 lekë**, sipas preventivit dhe kontratës për punë publike nr. 217, datë 16.07.2011, në objektin: “Rikonstruksion i Rrugës Chateau Linza- Shkoz”Kludiana”.

2. **Firma “B...” sh.p.k.**, me përfaqësues Dervish Bilali, në cilësinë e Projektuesit dhe hartuesit të preventivit të objektit “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Zihni Magani”+ ndërtim i palestrës së re” nga përlogaritja e gabuar e çmimeve të preventivit, në përcaktimin e fondit limit, duke shkaktuar dëm ekonomik në shumën **358,035 lekë** në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 28, pika 1, V.K.M. nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kreu II, pika 2, germa “a, me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12.

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kontratën individuale të punës, kërkojmë nga Kryetari i Bashkisw, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

##### **a. “Vërejtje me paralajmërim”, bazuar në Kontratën individuale të punës neni 13 germa (b).**

1. **B.K.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së të ardhurave Vendore
2. **L.K.** me detyrë inspektore Zyrës së të ardhurave Vendore
3. **H.N.** me detyrë inspektore Zyrës së të ardhurave Vendore, *pasi:*

-Nuk kanë ushtruar kontrole për mbajtjen e saktë të librave dhe mbajtjen e xhiros, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

-Nuk ka aplikuar gjoba në masën 5-25 për qind, ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar në afat detyrimet tatimore, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk i kanë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive për subjektet debitorë të biznesit të vogël, në kundërshtim me nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk ka kërkuar vendosjen e bares siguroese, për subjektet e biznesit të vogël debitorë, përkatësisht: Drejtorisë Rajonale të Transportit (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme), në kundërshtim me nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.

- Nuk kanë bërë përpjekje për arkëtimin e taksës për tokën bujqësore në shumën 1,721,788 lekë nga 93 familje të qytetit të Peqinit .

- Nuk kanë bërë përpjekje për arkëtimin e detyrimeve tatimore nga 7 subjekte të biznesit të madh, në vlerën 1.725.000 lekë,

Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë”, miratuar me VKB, nr. 42, datë 24.12.2009, neni 43 “Detyrat e sektorit të ardhurave lokale”.

**4. Sh.H.** me detyrë përgjegjës i Policisë Bashkiake, *pasi:*

-nuk ka verifikuar pajisjen me liçencë të tregëtarëve dhe personave të tjerë që meren me veprimtari shitblerje dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari në transportet rrugore, në kundërshtim me kërkesa të nenit 8, pikat 9 dhe 15 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”.

-për mungesë bashkëndimi me sektorin e taksave vendore dhe për pasojë deri më datën 31.12.2013, nuk kanë paguar detyrimet.

- për tokën bujqësore në shumën 1,721,788 lekë nga 93 familje.

- nga 7 subjekte të biznesit të madh, në vlerën 1.725.000 lekë,

- nga 12 subjekte të biznesit të vogël, në shumën 362,000 lekë.

- për mos propozimin dhe miratimin në këshillin bashkiak të paketës me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

**5. Xh.L.** me detyrë Drejtore Financës, *pasi:*

Nga mos kontrollimi i dokumentacionit të arkës dhe bankës ka krijuar një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në **shumën 317,587 lekë**, si vijon;

- Shuma prej **49,087 lekë** i shkaktuar si rezultat i mos kryerjes së shërbimit të pastrimit të Qytetit, duke raportuar më tepër në situacion dhe faturën tatimore, veprime në kundërshtim me nenin 4, çmimi i kontratës, të kontratës nr. 2 datë 15.02.2011 .

- Shuma prej **25,000 lekë** i shkaktuar për, pagesën e ish punonjësi me listë pagesës, pa u tatuar mbi tatimin mbi të ardhurat, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000, ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001, UMF nr. 3, datë 11.12.2002 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

- Shuma prej **243,500 lekë** i shkaktuar për blerje mallrash konsumi si kafe, qumësht e çajë, por në asnjë rast nuk ka dokumentacion justifikues ku janë përdorur, dhe për kë, veprime në kundërshtim germën ç, të pikës 1, të VKM nr. 472, datë 02.07.2011” Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” dhe me moszbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” dhe “Marrja në dorëzim e aktiveve të Furnizuara;

**6. F.M.** me detyrë specialiste e pagave *dhe*

**7. L.M.** me detyrë përgjegjëse e zyrës të Administratës, *pasi:*

- Nga mos kontrollimi i dokumentacionit, në strukturën e aparatit përveç nivelit arsimor të punonjësve nuk është përcaktuar, profili (specialiteti i diplomës së punonjësit) dhe niveli I diplomës të arsimit Universitar “Diplomë e Nivelit të Parë” (DNP)apo (DND), por thjesht "arsimi i lartë", veprim që bie ndesh me VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 i ndryshuar, me VKM nr 598, datë 27.4.2009. ku, ka krijuar një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në **shumën 618,576 lekë**, si vijon:

- Shuma prej **198,576 lekë** i shkaktuar për përfitim më tepër të pagës nga punonjësja e gjendjes Civile duke u paguar në një klasë më të lartë,

- Shuma prej **420,000 lekë** i shkaktuar nga 3 punonjës të bashkisë, për përfitim më tepër të pagës të cilët rezultojnë me arsim të mesëm dhe me diplomën e arsimit Universitar “Diplomë e Nivelit të Parë” (DNP), ku kanë përfituar pagesën për “Diplomë e Nivelit të Dytë” (DND).

**b. “Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët,” bazuar në Kontratën individuale të punës neni 13 germa (ç).**

**1. z. F.D.** me detyrën e Kryeinspektorit të INUV-it, *pasi:*

- ka ushtruar detyrën e Kryeinspektorit të INUV-it, me arsim të mesëm ndërtimi, ku rezulton se arsimimi i kryeinspektorit të INUV-it, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 ”Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të Inspektoratit Ndërtimorë Vendorë”, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin”.

Nga Bashkia Peqin me shkresë nr.209, prot, datë 16.06.2014, protokolluar në KLSH me nr.162/7 datë 18.06.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Piro Imeraj dhe Luan Kuka më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**